VENDIM
Nr. 102, datë 16.2.2022

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË POZICIONEVE KOORDINATOR TË RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

(Ndryshuar me vendimin nr. 196, datë 6.4.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

1.1 Në nivel qendror: Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Drejtoria Qendrore e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Instituti i Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", "Spitali Universitar i Traumës", Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, Spitali Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, Shërbimi Social Shtetëror.

1.2 Në nivel rajonal: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe spitalet rajonale.

2. Për pozicionin "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit:

a) për institucionet që janë pjesë e sistemit të shëndetësisë, të përcaktuara në nënpikën 1.1, të këtij vendimi, paga mujore është sipas lidhjes nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) për institucionet e tjera të përcaktuara në nënpikën 1.1, të këtij vendimi, kategoritë e pagave janë sipas lidhjes nr. 1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për pozicionin "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit:

a) për institucionet që janë pjesë e sistemit të shëndetësisë, të përcaktuara në nënpikën 1.2, të këtij vendimi, paga mujore është sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) për institucionet e tjera të përcaktuara në nënpikën 1.2, të këtij vendimi, kategoritë e pagave janë sipas lidhjes nr. 2/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Vlera e pagës së grupit dhe shtesa për vjetërsi, të përcaktuara në lidhjet nr. 1/1 e 2/1, të këtij vendimi, kanë të njëjtën vlerë dhe mënyrë llogaritjeje me atë të miratuar në vendimin

përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë me arsim të lartë në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

5. Elementet e strukturës së pagës për secilën kategori page të përcaktuar në lidhjet nr. 1/2 dhe nr. 2/2, të këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

5/1. Nëpunësit në pozicionet "koordinator" të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, përveç pagës mujore të përcaktuar në lidhjet nr. 1/1, nr. 1/2, nr. 2/1 dhe nr. 2/2, përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i secilit institucion, të përcaktuar në nënpikat 1.1 e 1.2, të këtij vendimi, dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

7. Vendimi nr. 716, datë 16.9.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës e të niveleve të pagave të përfaqësuesve të disa institucioneve të administratës shtetërore, në Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 1/1

Paga mujore për pozicionet "Koordinator", pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, për institucionet që janë pjesë e sistemit të shëndetësisë, të përcaktuara në pikën 1.1, të vendimit

POZICIONI	PAGA MUJORE		
	PAGA E GRUPIT/ KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS	SHTESA PËR VJETËRSI	SHTESA E POZICIONIT
Koordinator në: - Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".	1	2%	110.000
Koordinator në: - Spitalin Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"; - Spitalin Universitar të Traumës; - Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"; - Spitalin Universitar	1	2%	97.000

"Shefqet Ndroqi".			
Koordinator në: - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	2%	85.000
Koordinator në: - Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë; - Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinçi", Elbasan.	1	2%	82.000

Lidhja nr. 1/2

Kategoritë e pagave për pozicionet "Koordinator", pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, për institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 1.1, të vendimit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA E GRUPIT/ KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS
Koordinator në: - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	II-a	1
Koordinator në: - Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; - Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; - Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; - Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; - Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; - Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural; - Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; - Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;	II-b	1

- Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; - Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar; - Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë; - Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara; - Autoritetin Rrugor Shqiptar në nivel qendror; - Institutin e Shëndetit Publik; - Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror; - Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial; - Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror.		
Koordinator në: - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit; - Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.	III-a	1

Lidhja nr. 2/1

Paga mujore për pozicionet "Koordinator", pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, për institucionet që janë pjesë e sistemit të shëndetësisë, të përcaktuara në pikën 1.2 të vendimit

POZICIONI	**PAGA MUJORE**		
	PAGA E GRUPIT/ KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS	**SHTESA PËR VJETËRSI**	**SHTESA E POZICIONIT**
Koordinator në spitalet rajonale	1	2%	82.000

Lidhja nr. 2/2

Kategoritë e pagave për pozicionet "Koordinator", pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, për institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 1.2 të vendimit

POZICIONI	**KATEGORIA**	**PAGA E GRUPIT/**

		KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS
Koordinator në: - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	III-a	1
Koordinator në: - Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	III-a/1	1
Koordinator në: - Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; - Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar.	III-b	1

Shënim. Kategorizimi i drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e këtij institucioni.

Lidhja nr. 3

SHTESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
PËR NËPUNËSIT NË POZICIONET "KOORDINATOR", PJESË E RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT PËR INSTITUCIONET QË JANË PJESË E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI
(shtuar me vendimin nr. 196, datë 6.4.2022)

POZICIONI KOORDINATOR, NË:	**SHTESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE**
- Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	18.000
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave	15.000
- Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit - Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	10.000
- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" - Spitalin Obsetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" - Spitalin Universitar të Traumës. - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Koço Glozheni" - Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi". - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore - Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë - Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinci", Elbasan - Spitalet rajonale	5.000

- Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile - Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit - Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit - Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar - Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë - Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara - Autoritetin Rrugor Shqiptar në nivel qendror - Institutin e Shëndetit Publik - Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror - Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial - Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar	